



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-2759-2-2-1/C893
14 Nr. 490//24
Dt. 01.08.2024

KONTRATË PËR SHËRBIME MEDIALE
(KONTRATË KORNIZË)

E lidhur më dt. 01.08.2024, në Vushtrri.

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, rr. " Isa Boletini " nr. 10, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi** – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme **POROSITËSI**) , dhe
2. " **Ekonomia Online** " sh.p.k. me seli në Prishtinë, me ARBK : **810805335**, të cilën e përfaqëson : **Faton Osmani** , në tekstin e mëtejme **KRYESI I SHËRBIMIT**.

Lënda e kontratës: Shërbime mediale për aktivitete të Komunës së Vushtrrisë

Neni 1. Shërbimi

- 1.1** Porositësi, Komuna e Vushtrrisë, ka përcaktuar si nevojë : Shërbime mediale për aktivitete të Komunës së Vushtrrisë, ashtu sikurse është dhënë në Dokumentin Dosje e Tenderit, me nr. Prokurimi : **VU644 – 24 – 2759 - 221** dhe Nr. të brendshëm të prokurimit : **VU644 – 24 – 027 – 221**, ndërsa, O.E. " **Ekonomia Online** "sh.p.k. me seli në Prishtinë, duke angazhuar kapacitetet e saja njerëzore dhe teknike – mjetet e punës, do ti kryej shërbimet sikurse u theksua më lartë, ashtu sikurse është specifikuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit, si dhe në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veqanta të Kontratës, poashtu pjesë e Dosjes së Tenderit, që përfshinë shërbime, si vijon :
- Video ngjarje në muaj; të cilat caktohen nga zyra për marrëdhënie me publikun;
 - Intervistë me kryetarin;
 - Intervistë me ekzekutivin;
 - Video ngjarje- përmbledhje nga seancat e Kuvendit;
 - Përgatitja e videove promovionale;
 - Përcjellja e punimeve gjatë realizimit të projekteve para dhe pas përfundimit (Video para-pas);
 - Përmbledhje e videove në fund të vitit (Reportazh);
 - Menaxhimi i rrjeteve sociale: (Facebook, instagram, twitter, tiktok) dhe rrjetet

Neni 2. Periudha (Kohëzgjatja)

- 2.1.** Kryesi i Shërbimit do të ofroj shërbime për Porositësin për periudhën, nga dt. **31. 07.2024** deri më **30. 07.2027**, përfshirë edhe këtë datë, dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 2.2.** Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, vendosë të blejë shërbime në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë



- “porosinë” tek Kryesi I Shërbimeve , duke specifikuar listën me shërbimet që duhen ekzekutuar, me sasi të tyre përkatëse.
- 2.3. Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen dhe / ose porosinë e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.
- 2.2. Si parakusht për hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate dhe në pajtim me dispozitat e LPP-së, Kryesi i Shërbimeve do të bëjë një Sigurim të ekzekutimit të Kontratës në një shumë prej 10 % të vlerës së Kontratës.

Neni 3. Kostoja (Çmimi)

- 3.1. Kostoja gjegjësisht çmimi i kontratës do të jetë për njësi. Vlera e përafërt e shërbimeve të planifikuara, për periudhën trevjeçare, është në shumë prej 30,000.00€, që paraqet çmimin total të çmimeve të të gjithë të shërbimeve, në pajtim me specifikimin teknik të dosjes së tenderit.
- 3.2. Njësia Kërkuese, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i A.K. kanë përgjegjësinë e plotë që të kujdesen që sasi të realizuara (shpenzuara) të shërbimeve dhe / ose punëve të porositura të mos ndryshojnë substancialisht në raport me peshën e dhënë sipas grupeve të nëntotaleve si në Përshkrimin e shërbimeve dhe/ ose punimeve si dhe çmimeve, që don të thotë se nuk duhet të porositen vetëm shërbime / ose punë nga një pozicion apo grup i shërbimeve dhe / ose punëve të caktuara, por porosia duhet të jetë proporcionale dhe në raport me peshën e dhënë si në Përshkrimin e shërbimeve dhe Çmimeve.
- 3.3. Nëse Urdhër blerjet tejkalojnë vlerën totale indikative të saktësuar në nenin 3 paragrafi 3.1 të kësaj Kontrate Publike Kornizë, pa marrë parasysh datën e skadimit të Kontratës Publike Kornizë të saktësuar në nenin 2 paragrafi 2.1 të kësaj kontrate, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.
- 3.4. Sasi të artikujve, si në pjesën II. Lista e Artikujve dhe Çmimeve, pjesë e kësaj Kontrate, nuk janë të parapara, dhe pragu plus/minus tridhjet përqind (30 %) nuk vlenë.
- 3.5. Nëse Urdhërblerja është dhënë pak kohë pra se kontrata publike kornizë të skadoj, dërgesa respektivisht shërbimi mund të ekzekutohet edhe pas dates së skadimit të kontratës.
- 3.6. Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve dhe/ose punëve të përmendura në nenin 1

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Çmimi total DDP
Kategoria A	Shërbimet për Përgaditjen e video-ngjarjeve me kërke zyres për marrëdhënie me publikun dhe përcjellja e punëgjatë realizimit të projekteve		
1	Video ngjarje me kërkesën e zyrës për marrëdhënie me publikun, videot do të realizohen në Komune dhe gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë sipas nevojës së paraqitur (02-20 min)	1	169,00€
2	Përcjellja e punimeve gjatë realizimit të projekteve para dhe pas përfundimit përmes videove (do të ingjizohet vendi ku do të zhvillohen punimet dhe pas përfundimit të punimeve me kamere dhe dron (03-20 min)	1	219,00€
Kategoria B	Shërbimet e përgaditjes së videove promovionale dhe intervistave		
1	Përgatitja e videove promovionale, (Do të përgatitet video promovionale që përcakton zyra e informimit, për një projekt apo punë e cila ka përfunduar, duke cekur statistika të ndryshme). (05-20 min)	1	169,00€



2	Intervistë me Kryetarin e Komunës, me kërkesë të zyrës së informimit caktohet data dhe vendi i intervistës me kryetarin e komunës) (05-15 min), në objektin (studion e Operatorit Ekonomik).	1	89,00€
3	Intervista me ekzekutivin në bazë të kërkesës së zyra për informime cila përcakton vendin, datën dhe orën se ku do të bëhet intervista (05-15 min)	1	79,00€
Kategoria C	Shërbimet e përgatitjes së video-ngjarjeve me përmbledhje seancat e kuvendit përmbledhjeve të videove në fundvite menaxhimi i rrjeteve sociale		
1	Video ngjarje- përmbledhje nga seancat e kuvendit, pas përfundimit të seancës së kuvendit komunal në Vushtrrisë, të përgatitët përmbledhje e fjalimeve kryesore gjatë seancës, video të jetë e gatshme po atë ditë për publikim).(10-25 min)	1	99,00€
2	Përmbledhje e videove në fund të vitit (Reportazh). Me kërkesë të zyrës së informimit të përgatitët video reportazh në fund të vitit i cili duhet të jetë në detaje, dhe i realizuar mirë. (10-35 min)	1	99,00€
3	Menaxhimi i rrjeteve sociale: (Facebook, instagram, twitter, tiktok) dhe rrjetet sociale zyrtare të kryetarit.		189,00€

- 3.7. Çmimet e kontraktuara dhe pagesat do të jenë në euro dhe do të përfshijnë gjitha taksat dhe shpenzimet që do të jenë të nevojshme për kryerjen, në mënyrë cilësore, të Shërbimeve të pranuar.
- 3.8. Ndryshimet eventuale të çmimeve të Shërbimeve dhe të materialit të paraparë sipas specifikimit bien në barrë të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 4. Pagesa

- 4.1. Kërkesa për pagesën do të bahet me shkrim nga Kryesi i Shërbimit, e shoqëruar me një faturë, në të cilën përshkruhen shërbimet e kryera dhe të pranuar si dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm në bazë të kësaj Kontrate.
- 4.2. Pagesa do të bëhet nga Porositësi me përpikëri pas pranimit të kërkesës së dokumentuar (faturës dhe dokumenteve tjera të nevojshme – konfirmimit me shkrim të Menaxherit të Kontratës të caktuar nga Porositësi, në bazë të kësaj Kontrate), por në asnjë rast jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të kërkesës së tillë, me kusht që sidoqoftë të gjitha obligimet e Kryesit të Shërbimeve në bazë të kësaj kontrate të kryhen me përpikëri.
- 4.3. Pagesa, në bazë të faturës së rregullt dhe të kompletuar, nga Porositësi do të depozitohet në xhironlogarinë bankare të Kryesit të Shërbimeve, konform Kushteve të Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës, pjesë e Dosjes së Tenderit dhe të dhënave në pjesën Identifikimi Financiar të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 5. Menaxhimi i projektit dhe Nënkontrata

- 5.1. Në pajtim me të dhënat e paraqitura si në dokumentet e dosjes së tenderit, një menaxher i Kontratës i Kryesit të Shërbimeve do të emërohet pas lidhjes – nënshkrimit të kontratës, ndërsa, nga ana e tij Autoriteti Kontraktues, në pajtim me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë qështje, do të emëroi Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës.
- 5.2. Kryesi i Shërbimeve, në asnjë rast, nuk mundë të hyjë në asnjë nënkontratë për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara me Porositësin përveç nëse Porositësi për këtë e ka dhënë pëlqimin me shkrim më herët për një nënkontratë të tillë.



Neni 6. Përgjegjësia

- 6.1. Porositësi, nga Kryesi i Shërbimeve, është i mbuluar me një vlerë prej **10 % të vlerës së përgjithshme të Kontratës**, në emër të Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës.
- 6.2. Nëse Kontraktuesi – Kryesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoi furnizimet dhe / ose shërbimet e porositura brenda limiteve kohore të përcaktuara nga Porositësi, Autoriteti Kontraktues – Porositësi, në datën e caktuar prej Menaxherit të Kontratës së Autoritetit Kontraktues gjegjësisht në datën e dërgimit të Fletëporosisë, Autoritetit Kontraktues do të ketë të drejtë që gjitha furnizimet dhe / ose shërbimet e domosdoshme t'i kryejë përmes një kontraktori tjetër e në barrë – shpenzime të Kryesit të shërbimeve ndërsa, për çdo ditë vonesë do të aplikoi penale në shumë 0.25% në ditë të vlerës totale të porosisë e cila llogaritet nga dita e parapare për përfundim të shërbimeve.
- 6.3. Çdo kërkesë e Njësisë Kërkuese – Menaxherit të Kontratës duhet të jetë e specifikuar saktësisht nga Njësia Kërkuese, dhe do t'i dërgohet Kryesit të Shërbimeve përmes Menaxherit të Kontratës të A.K.
- 6.4. Për gjitha çështjet që lidhen me vonesën e Kryesit të shërbimeve e të cilat nuk janë rregulluara me nenin paraprak të kësaj Kontrate, do të vlejnjë rregullat – dispozitat si në Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës, pjesë e Dosjes së tenderit me nr. **Prokurimi : VU644 – 24 – 2759 - 221 dhe Nr. të brendshëm të prokurimit : VU644 – 24 – 027 – 221**
- 6.5. Kryesi i Shërbimeve nuk ka përgjegjësi për humbje apo dëmtimet si pasojë e ngjarjeve që paraqiten jashtë mundësisë së vet të arsyeshme për t'i kontrolluar apo eliminuar shkaqet, faktorët dhe dëmet e shkaktuara nga të ashtuquajturat Fuqitë Madhore.

Neni 7. Përfundimi i Kontratës

- 7.1. Kjo Kontratë do të përfundojë në bazë të ligjit pas periudhës së përcaktuar me nenin 2 (dy) të kësaj Kontrate.

Neni 8. Ndërprerja për shkak të mospërbushjes së detyrimeve

- 8.1. Porositësi apo përfaqësuesi i tij do të kenë të drejtën për të inspektuar dhe/ose testuar shërbimet e ofruara, në çdo kohë dhe në çdo vend , për të konfirmuar përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e kryerjes së shërbimeve konform kërkesave dhe rregullave të përcaktuara nga të dyja palët.
- 8.2. Nëse ndonjë nga shërbimet e inspektuara apo të testuara nuk është konform Specifikimeve të Kërkesës si në dokumentin e Dosjes së Tenderit, Porositësi mund të kërkojë nga Kryesi i Shërbimeve që ky i fundit t'i ndërmarr gjitha veprimet e nevojshme për të plotësuar dhe nëse përmirësimet nuk ndodhin në kohën më të shkurtër të arsyeshme atëherë Porositësi mund të kërkojë ndërprerjen e Kontratës gjegjësisht refuzimin e shërbimeve dhe / ose furnizimeve, pasi që Kryesi i Shërbimeve të jetë paralajmëruar me shkrim
- 8.3. Nëse Kryesi i Shërbimeve dështon t'i përmirësojë dhe/ose korrigjojë furnizimet dhe / ose shërbimet e porositura në një afat sa më të shkurtër dhe për pasojë vijë deri te ndërprerja e Kontratës atëherë Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet shtesë dhe dëmet që rrjedhin pastaj.

Neni 9. Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Kjo Kontratë do të interpretohet në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë.

Neni 10. Njoftimet

- 10.1. Çdo njoftim i bërë nga njëra palë palës tjetër, në bazë të kësaj Kontrate, do të dërgohet palës tjetër me shkrim personalisht, përmes postës, faksit ose postës elektronike të konfirmuar në të njëjtën datë.
- 10.2. Palët janë të obliguar ta njoftojnë njëra tjetrën për ndryshimin eventual të adresës. Njoftimi do të jetë efektiv kur pranohet ose në datën e hyrjes në fuqi të njoftimit.



Neni 11. Të ndryshme



- 11.1. Çdo amendament/ndryshim në këtë Kontratë duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga të dyja palët.


Neni 12. Zgjidhja e kontesteve

- 12.1. Palët do të mundohen të negociojnë për një zgjidhje miqësore të kontesteve, polemika ose pretendime që dalin nga ose në lidhje me këtë Kontratë, ose me shkeljen e rregullave , ndërprerjen ose vlefshmërinë, ashtu sikurse është përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.
- 12.2. Çdo paqartësi që del në raport me këtë Kontratë dhe nëse nuk ka mundur të zgjidhet në mënyrë tjetër dhe/ose miqësore do të paraqitet para një gjyqi kompetent në Kosovë, në pajtim me ligjin Kosovare ndërsa, për bazë do të mirën dispozita e përcaktuara si në Kushtet e përgjithshme ose/ dhe të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me nr. Prokurimi : VU644 – 24 – 2759 - 221 dhe Nr. të brendshëm të prokurimit : VU644 – 24 – 027 – 221
- 12.3. Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) origjinale, dhe të nënshkruhet nga të dy palët, nga të cilat 3(tri) origjinale për Porositësin dhe 1(një) original për Kryesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna
e Vushtrisë

Për Operatorin Ekonomik: "Ekonomia Online
"sh.p.k. – Prishtinë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Faton Osmani
Pozita:	Drejtor	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.08.2024	Data:	01.08.2024
Vula:		Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofruesi i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA



Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi nenit	i	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	i	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Komunale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.
		2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuha në përdorim zyrtarë.
Obligimet Autoritetit Kontraktues	e	12.3	Autoritet Kontraktues do të emëroj Menaxherin e Kontratës dhe Komisionin për menaxhim dhe pranim të shërbimeve
Siguria ekzekutimit	e	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është : 3,000.00€ (Tremijë pikë zerozero euro) Dokumenti - Polisa e sigurim apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës për 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi shërbimit	i	15.1	N/A
Kualiteti Kontrollit	i	17.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së ekzekutimit të shërbimeve do të bëhet nga komisioni i pranimit të shërbimeve dhe Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues. Asnjë ekzekutimi i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet me raport cilësia dhe sasi, komisioni i pranimit të shërbimeve dhe Menaxheri i Kontratës
Garancioni shërbimete kryera	për	21.1	Garancioni për cilësinë, përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë ligjore të shërbimeve do të jetë përgjegjësi e Kryesit të Shërbimeve - Kontraktuesit.
Obligimet kryesit shërbimev	e të		Në rast reklamimi të cilësisë së shërbimeve, Kryesi i Shërbimeve duhet të pajtohet, që pa asnjë kundërshtim, të korrigoj porosinë e reklamuar, në një afat jo më të gjatë se 1 (një) ditë kalendarike nga data e dërgimit të reklamimit. Kryesi i Shërbimeve duhet të siguroj Kontraktuesin se porositë e dorëzuara do të ekzekutohen brenda një periudhë kohore të dëshirueshme dhe në pajtim të plotë dhe pa asnjë përjashtim

		<p>me kërkesat e saktësuar si në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.</p> <p>Shërbimet do të kryhen sipas porosive, operatori ekonomik duhet të jetë i gatëssem që në çdo moment të kryej shërbimet e porositura dhe po ashtu duhet që në afatin sa më të shkurtër kohor të realizoj videot / produktet që dalin si rezultat i shërbimeve të realizuara, në vazhdimësi konform specifikave teknike, duke u kordinuar me menaxherin e kontratës të Autoriteti Kontraktues.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes		Në pajtim të plotë me nenin 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore		Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Sherbime Mediale per Autoritetin Kontraktues, për periudhën 36 mujore me nr. prokurimi : VU644 - 24 - 2759 - 221 dhe nr. brendshem : VU644-24-027-221							
Nr.	Përshkrimi i Artikujeve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 70% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë A
1	Video ngjarje me kërkesën e zyrës për marrëdhënie me publikun, videot do te realizohen ne Komune dhe gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë sipas nevojës se paraqitur (02-20 min)	shërbim	1	169,00	169,00	0.50	50%
2	Përcjellja e punimeve gjatë realizimit të projekteve para dhe pas përfundimit përmes videove (do te ingjizohet vendi ku do te zhvillohen punimet dhe pas përfundimit te punimeve me kamere dhe dron (03-20 min)	shërbim	1	219,00	219,00		
KATEGORIA A -TOTALI (1 - 2)							15,000.00
Nr.	Përshkrimi i Artikujeve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 15% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë B
4	Përgatitja e videove promovionale, (Do të përgatitet video promovionale që përcakton zyra e informimit, për një projekt apo punë e cila ka përfunduar, duke cekur statistika të ndryshme). (05-20 min)	Shërbim	1	169.00	169.00	0.30	30%
5	Intervistë me Kryetarin e Komunës, me kërkesë të zyrës së informimit caktohet data dhe vendi i intervistës me kryetarin e komunës) (05-15 min), në objektin (studion e Operatorit Ekonomik).	Shërbim	1	89.00	89.00		
6	Intervista me ekzekutivin në bazë të kërkesës së zyra për informime cila përcakton vendin, datën dhe orën se ku do të bëhet intervista (05-15 min)	Shërbim	1	79.00	79.00		
KATEGORIA B -TOTALI (4-6)							9,000.00

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€	Çmimi total 15% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë C
7	Video ngjarje- përmbledhje nga seancat e kuvendit, pas përfundimit të seancës së kuvendit komunal në Vushtrrisë, të përgatitët përmbledhje e fjalimeve kryesore gjatë seancës, video të jetë e gatshme po atë ditë për publikim).(10-25 min)	shërbim	1	99.00	99.00	0.20	20%
8	Përmbledhje e videove në fund të vitit (Reportazh). Me kërkesë të zyrës së informimit të përgatitët video reportazh në fund të vitit i cili duhet të jetë në detaje, dhe i realizuar mirë. (10-35 min)	shërbim	1	99.00	99.00		
9	Menaxhimi i rrjeteve sociale: (Facebook, instagram, twiter, tiktok) dhe rrjetet sociale zyrtare të kryetarit.	shërbim	1	189.00	189.00		
KATEGORIA C -TOTALI (7 -9)							6,000.00

Vlera Totale	30,000.00
--------------	-----------

	Për Autoritetin Kontraktues: Komuna Vushtri	Për Kontraktuesin: " Ekonomia Online"sh.p.k. Prishtinë
Emri:	Ilmi Azemi	Emri: Faton Osmani
Pozita:	drejtor	Pozita: drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi: 
Data:	31.07.2024	Data: 31.07.2024
Vula:		Vula:

